

SEKSIONI I TRETË
VENDIM

Kërkesa nr. 10893/09
Engjellush BEKTESHI
kundër Shqipërisë
(sibih tabelën bashkëngjitur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë) e mbledhur më 5 maj 2022, si Komision, e përbërë nga:

Andreas Zünd, *kryetar,*

Darian Pavli,

Mikhail Lobov, *gjyqtarë,*

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendësregjistrare e përkohshme e Seksionit,*

pasi morën në konsideratë kërkesën e mësipërme, paraqitur më 18 shkurt 2009,

duke marrë në konsideratë parashtrimin e paraqitur nga Qeveria e paditur e cila i kërkon Gjykatës të përjashtojë kërkesën nga lista e çështjeve, si edhe përgjigjen e kërkuarit ndaj këtij parashtrimi, pasi diskutoi, vendos si më poshtë:

FAKTET DHE PROCEDURA

Detajet e kërkuarit paraqiten në tabelën bashkëngjitur. Ai u përfaqësua nga z. A. Hajdari, një avokat i cili e ushtron profesionin në Tiranë.

Ankesat e kërkuarit sipas nenit 6 § 1 të Konventës, në lidhje me ekzekutimin e vonuar të një vendimi të brendshëm, dhe sipas nenit 13 të Konventës për mungesën e një mjeti efikas të brendshëm në lidhje me këtë aspekt, iu komunikuan Qeverisë së Shqipërisë (Qeveria).

Qeveria parashtrroi një deklaratë me qëllim zgjidhjen e problematikave të ngritura me anë të këtyre ankesave. Në vijim, Qeveria i kërkoj Gjykatës të përjashtonte kërkesën.

Qeveria pranonte se në çështjen e kërkuarit ishte shkelur neni 6 § 1 i Konventës. Qeveria e bëri me dijeni Gjykatën se vendimi përfundimtar ishte ekzekutuar plotësisht dhe se kërkuarit i ishin paguar plotësisht pagat e prapambetura më 17 dhjetor 2009. Gjithashtu, më 13 shtator 2010, kërkuari ishte rikthyer në punën e tij të mëparshme. Qeveria ofronte t'i paguante kërkuarit shumën e detajuar në tabelën bashkëlidhur dhe fton Gjykatën ta përjashtonte kërkesën nga lista e çështjeve. Shuma do të konvertohej në monedhën e shtetit të paditur në normën e zbatueshme në datën e pagesës dhe do të paguhej brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës. Në rast të mosshlyerjes së kësaj shume brenda periudhës tremujore të sipërpërmendur, Qeveria merrte përsipër të paguante interesin e thjeshtë ndaj saj, që prej përfundimit të asaj periudhe deri në shlyerje, në normën e barasvlershme me normën marginale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindje.

Pagesa do të përbëjë zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Kërkuari bëri me dijeni Gjykatën se binte dakord me kushtet e deklaratës.

LIGJI

Gjykata konstaton se, pas dakordësimit të shprehur të kërkuarit me kushtet e deklaratës së bërë nga Qeveria, çështja duhet të trajtohet si një zgjidhje miqësore midis palëve sa i përket ankesës së kërkuarit, sipas nenit 6 § 1.

Për këtë arsye, Gjykata mban në vëmendje zgjidhjen miqësore të arritur midis palëve. Ajo ka bindjen se zgjidhja mbështetet në respektimin e të drejtave të njeriut sipas parashikimit të Konventës

dhe protokolleve të saj, dhe nuk konstaton asnjë arsye për të justifikuar shqyrtimin e mëtejshëm të kësaj pjese të kërkesës.

Për sa më sipër, është me vend që çështja të përjashtohet nga lista për sa i përket ankesës së trajtuar në deklaratën e bërë nga ana e Qeverisë, të pranuar nga kërkuesi.

Në lidhje me faktet e çështjes, deklaratën e Qeverisë dhe vendimin e Gjykatës për ta përjashtuar pjesën e kërkesës mbi ankesën në mbështetje të nenit 6 § 1, Gjykata gjykon se çështja ligjore kryesore në çështjen konkrete është zgjidhur. Në këtë mënyrë, ajo arrin në përfundimin se nuk është e nevojshme që ankesat e kërkuetit paraqitur në mbështetje të nenit 1, të protokollit nr. 1, të Konventës dhe nenit 13 të Konventës të shqyrtohen në mënyrë të veçantë.

Për këto arsye, Gjykata, në mënyrë unanime,

Vendos ta përjashtojë pjesën e kërkesës të përfshirë në zgjidhjen miqësore nga lista e saj e çështjeve në mbështetje të nenit 39 të Konventës;

Vendos se nuk është e nevojshme të shqyrtohet pjesa tjetër e kërkesës.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim, më 25 maj 2022.

Viktoria Maradudina

ZËVENDËSREGJISTRARE E PËRKOHSHME

Andreas Zünd

KRYETAR

SHTOJCË

Kërkesë e cila parashtron ankesa sipas nenit 6 § 1 të Konventës (mosekzekutimi ose ekzekutimi i vonuar i vendimeve të brendshme)

Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkuetit Viti i lindjes	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Data e marrjes së deklaratës së Qeverisë	Data e marrjes së pranimi të kërkuetit	Shuma e dhënë për dëmin jomonetar dhe kostot e shpenzimet (në euro) ¹
10893/09 18/02/2009	Engjellush BEKTESHI 1966	Hajdari Artan Tiranë	18.11.2021	10.1.2022	1200

¹ Plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuetit.